



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Komuna e Prishtinës
Pristina Obstina-Municipality of Pristina



SEKTORI I PROKURIMIT - KABINETI I KRYETARIT

Bazuar në nenin 108/A paragrafi 10 nënparagrafi 10.2 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik lidhur me nenin 60 të Ligjit nr. 05/L-068 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin nr. 04/L-237 dhe me ligjin nr. 05/L-092, si dhe duke u bazuar në nenin 61.3. lidhur me nenin 62 paragrafi 62.1 nënparagrafi d) si dhe nenin 63 paragrafi 63.1 nënparagrafi 63.1.1 të Rregullores (A01) nr. 001/2022 për Prokurimin Publik, duke vendosur sipas kërkesës për rishqyrtim të operatorit ekonomik “Eing com shpk” të datës 04.05.2026 kundër njoftimit mbi vendimin lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “163 Ndërtimi, rregullimi, vendosja dhe pastrimi i lumenjëve dhe kanalizimeve për mbrojtje nga vërshimet - Ritender” me nr. të prokurimit 616-25-2547-1-1-1, Komuna e Prishtinës (autoriteti kontraktues) përmes zyrtarit përgjegjës të prokurimit nxjerr këtë:

V E N D I M

- I. **REFUZOHET** kërkesa për rishqyrtim e operatorit ekonomik “Eing com shpk” të datës 04.05.2026 kundër njoftimit mbi vendimin lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “163 Ndërtimi, rregullimi, vendosja dhe pastrimi i lumenjëve dhe kanalizimeve për mbrojtje nga vërshimet - Ritender” me nr. të prokurimit 616-25-2547-1-1-1.
- II. **AUTORIZOHET** autoriteti kontraktues - Komuna e Prishtinës që të vazhdoj me aktivitetin e prokurimit të përcaktuar si në pikën I të këtij vendimi.
- III. **NJOFTOHEN** palët e interesuara lidhur me këtë vendim përmes publikimit në platformën elektronike E-Prokurimi në adresën <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.
- IV. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

Arsyetim

Operatori ekonomik “Eing com shpk” (tutje “parashtruesi”) me datë 04.05.2026 ka paraqitur kërkesë për rishqyrtim kundër njoftimit mbi vendimin lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “163 Ndërtimi, rregullimi, vendosja dhe pastrimi i lumenjëve dhe kanalizimeve për mbrojtje nga vërshimet - Ritender” me nr. të prokurimit 616-25-2547-1-1-1.

Gjatë shqyrtimit paraprak të kërkesës për rishqyrtim të parashtruesit është gjetur se kërkesa është e lejuar dhe është parashtruar brenda afatit nga personi i autorizuar si dhe nuk ekzistojnë pengesa tjera për të shqyrtuar kërkesën e parashtruesit. Në këtë mënyrë janë plotësuar kushtet për të vazhduar me shqyrtimin meritore (*in meritum*) të kërkesës.

Pretendimet ankimore të parashtruesit:

“Për këtë pretendim ankimor fillimisht ju sqarojm se, ne jemi GOE dhe kemi ofertuar me nje oferte te perbashket ku pjese e ketij grupi se bashku me OE “EING COM” SH.P.K eshte edhe OE “MAVI DENIZ ÇEVRE HIZMETLERI” A.S. si anetar i konzorciumit. Pretendimi nga ana juaj NUK QENDRON per faktin se dokumentit te cilit ju i referoheni me pretendimin se eshte “dokument i falsifikuar”, ky dokument i bashkangjitur ne oferte nuk ka kurfar relevance dhe asnje lidhje të qfardo natyre me aktivitetin ne fjale dhe permbushjen e kerkesave te dosjes se tenderit, dhe nuk behet fjale per falsifikimin e asnje dokumenti i cili gjendet ne oferten tone.

Vleresimi i tenderit eshte ne pergjegjesine e autoritetit kontraktuese dhe se vleresimi i tenderit nga nje pale e trete tregon mungese integriteti dhe profesioanlizmi ne kete proces.

Edhe ne rastin konkret, menqenese behet fjale per pjesemarrje ne kontratat publike, ne kete kontekst ne asnje rrethane nuk kemi cka te fshehemi asgje nga askush, por dhenia e qasjes ne oferte nga AK per palet e treta ne kundertshtim me LPP-ne eshte shkelje e rende dhe tendence per komprometimin e te gjithë procesit.

Pretendimi i ri i paraqitur nga AK ne kete faze pas dy vendimeve te OSHP-se per ne, do te thote shume, sepse shihet tendenca e qarte ndaj neve si dhe ka te beje me mos respektimin e Vendimeve te OSHP-se. Mos respektimi i vendimit te pare, dhe nxjerrja e vendimit te dyte nga OSHP ne favor te grupit tone, AK nuk i respekton vendimet ne fjale dhe fillon nxjerrjen e pretenimeve te reja te cilat pas dy rivlersimeve te tenderit nxjerr pretendime te reja, me kete rast AK bene shkelje ligjore sepse i gjithë ky vleresim bazohet ne pretenimet e nje pale te trete sic eshte OJQ AVONET, kur dihet shume mire se qfare OJQ-je eshte AVONET. Kjo OJQ nuk gezon fare kredibilitet, per me teper i gjithë aktiviteti i saj bazohet vetem per qellime te perfitimeve personale.

Lidhur me kete ju sqarojm se VERTETIMET sipas legjislacionit per prokurimin publik ne lidhje me kerkesat e pershtatshmerise do te kerkohen te dorezohen nga tenderuesi te cilin autoriteti kontraktues ka per qellim qe ta shperblej me kontrate sipas nenit 65 te lpp-se dhe se keto dokumente do te dorezohen nga tenderuesi para publikimit te njoftimit B58 mbi vendimin e AK. Pra dokumenti te cilit ju i referoheni i cili eshte bashkangjite ne oferten tone nga antari i konzorciumit eshte jo relevant dhe nuk ka asnje nderlidhje ne raport me dokumentacionin sipas nenit 65 te LPP-se.

Fakti qe ky aktivitet i prokurimit ka qene qe nje kohe te gjate ne vleresim dhe rivleresim si rezultat i mosrespektimit te vendimeve nga ana e AK-se, dhe se afati i fundit i dorezimit te vertetimeve eshte i shkurt, ne kemi komunikuar ne vazhdimesi me anetarin e konzorciumit dhe i kemi kerkuar dokumentet qe ti kemi te gatshme kurdo qe AK na i kërkon. Per me shume mund te ju paraqesim qdo korospodence ndermjet OE “EING COM” SH.P.K. dhe “MAVI DENIZ ÇEVRE HIZMETLERI” A.S. e cila nderlidhet me qeshtjen ne fjale.

Dokumentet e paraqitura si me larte vertetojn pershtatshmerin dhe pergjegjshmerin tone ne kete aktivitet te prokurimit, prandaj autoriteti kontraktues do te duhej qe per qdo paqartesi eventuale te kerkonte sqarime shtese nga ne si GOE ne menyre qe vleresimi i tendereve te behet ne perputhje me kerkesat e dosjes se tenderit dhe ne asnje rrethan nuk do duhej te ndikohej nga OJQ apo media te cilat ne munges te informacioneve tentojn te diktojn proceset e prokurimit, rrjedhimisht edhe rezultatin e ketij aktiviteti te prokurimit.

Andaj parasegjithash autoriteti kontraktues per qdo paqartesi eventuale ka mundur te kerkoj sqarime shtese per qeshtjen ne fjale parase te merr vendim per eliminimin tone krejtesisht te pabazuar dhe te paargumentuar”.

Parashtruesi po ashtu ka parashtruar pretendime ankimore sipas të cilave oferta e tenderuesit te rekomanduar për kontratë është e papërgjegjshme për arsyet e prezantuara në kërkesën për rishqyrtim.

Sipas letrës standarde për tenderuesin e eliminuar, parashtruesi është shpallur si tenderues i papërgjegjshëm dhe është eliminuar për arsyet si në vijim:



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Komuna e Prishtinës
Pristina Obština - Municipality of Pristina
SEKTORI I PROKURIMIT - KABINETI I KRYETARIT
KUVENDI I KOMUNËS SË PRISHTINËS



Letër standarde për tenderuesin e eliminuar¹

Titulli i kontratës i dhënë nga autoriteti kontraktues:

163 “Ndërtimi, rregullimi, vendosja dhe pastrimi i lumenjëve dhe kanalizimeve për mbrojtje nga vërshimet” – Rivlerësim.

Numri i aktivitetit të prokurimit

Nr i prokurimit	616-25-2547-1-1-1
Nr i brendshëm	616-25-77-1-1-1

Të nderuar (a)

Grupi i Operatorëve Ekonomik: “EING COM” SH.P.K MAVI DENIZ ÇEVRE HIZMETLERI A.Ş. Dumosh, Podujevë.

Faleminderit që morët pjesë në procedurën e lartshënuar të prokurimit publik. Procedura është udhëhequr në pajtim me Ligjin për Prokurimin Publik Nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, siç citohet në vazhdim “LPP”.

Tenderi juaj është vlerësuar me kujdes sipas kushteve dhe kërkesave të dhëna në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit.

Me keqardhje ju njoftojmë se jeni eliminuar për shkak të arsyeve në vijim:

ARSYETIM

Komisioni i vlerësimit, pas ekzaminimit, vlerësimit dhe krahasimit të ofertës tuaj, ka konstatuar se oferta juaj është e papërgjegjshme, për arsyet si në vijim:

Specifikimet teknike të detyrueshme nuk i përmbush kërkesat sipas kriterit të DT-së ku:

Materialet: Janë ofruar materiale PVC (standard) dhe PU (opsional), të cilat nuk përputhen me kërkesat për materiale PP dhe PE. Kjo përbën mospërputhje thelbësore, pasi materialet e kërkuara sigurojnë qëndrueshmëri dhe fleksibilitet më të lartë në kushte të ndryshme klimatike, duke ndihmuar në zgjatjen e jetëgjatësisë së sistemit.

Lidhjet dhe Ventilat: Janë ofertuar standarde ASTM Z dhe ASTM Universal, ndërsa në Dosjen e Tenderit kërkohet standardi STORZ 110A. STORZ 110A është një standard ndërkombëtar dhe përdorimi i një lidhjeje tjetër mund të shkaktojë vështirësi në lidhjen e tubave me pajisje të tjera të përputhshme.

Pikat Mbushëse: Nuk janë ofruar dëshmi të mjaftueshme që sistemi mund të mbushet në mënyrë të centralizuar nga një pikë e vetme, siç kërkohet në Dosjen e Tenderit.

Gjatësia e Seksioneve: Janë ofertuar seksione deri në 20 metra, ndërsa në Dosjen e Tenderit kërkohen seksione me gjatësi 100 dhe 200 metra për shkak të përshtatjeve në terene të ndryshme, stabilitetit, qëndrueshmërisë ndaj presionit.

Te sigurimi i tenderit numri i prokurimit nuk përputhet me numrin e këtij aktiviteti të prokurimit sipas DT-së.

SHËNIM ME RËNDËSI: Gjatë vlerësimit të Dosjës së Tenderit, kërkesa e përshtatshmerisë pika e 2) Vërtetim nga Administrata Tatimore – është konstatuar dyshime i arsyeshme lidhur me autenticitetin dhe vlefshmërinë juridike të paraqitur me titull: “Income Tax and Vat Clearance Certificate 2025 - Mavi Deniz (Final)”.

Për këtë arsye, Komisioni i vlerësimit ka kërkuar verifikim zyrtar përmes e-mailit (datë 21 prill 2026) nga Administrata Tatimore e Republikës së Turqisë.

Në përgjigjen e pranuar po në të njëjtën datë, është konfirmuar se dokumenti i paraqitur nuk përputhet me të dhënat zyrtare të sistemit të verifikimit

<https://dijital.gib.gov.tr/dogrulamalar/mukellefiyetDogrulama>. Komisioni ka verifikuar dokumentin me nr Identifikues 6130463468 dhe me Nr të aplikacionit 071rhjppvq17cd të datës 22.04.2025 dhe ka konstatuar se i njëjti është i falsifikuar.

Ky konstatim përbën bazë të rëndësishme juridike, pasi dëshmon se dokumentet e tilla janë të verifikueshme dhe çdo mospërputhje me të dhënat zyrtare përbën shkelje ligjore. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me Ligjin për Prokurim Publik nr. 04/L-042 dhe mund të bien ndesh me dispozitat e Kodit Penal të Republikës së Kosovës, përkatësisht: Nenit 415 – Keqpërdorimi dhe mashtrimi në prokurim publik, Nenit 383 – Deklarimi i rremë nën betim dhe Nenit 390 – Falsifikimi i dokumenteve.

Përfundimi: Duke u bazuar në të gjitha arsyet e lartcekura, Komisioni i rivlerësimit për ofertën e Grupit të Operatorëve Ekonomik, konstaton se është ofertë e papërgjegjshme dhe eliminohet për këtë aktivitet të Prokurimit.

Fillimisht duhet cekur se AK ka dërguar në OSHP një kërkesë për vendosjen e parashtruesit në listën e zezë për shkak të dyshimeve për falsifikim të dokumenteve dhe mashtrim në prokurim publik.

Lidhur me pretendimet ankimore të parashtruesit sa i përket arsyeve eliminuese të prezantuara në letrën standarde përmes të cilit parashtruesi është eliminuar si i papërgjegjshëm, është gjetur që arsyet e evidentuara nga komisioni vlerësues për eliminimin e parashtruesit si të papërgjegjshëm janë të sakta, të matshme dhe të ligjshme. Rrjedhimisht është gjetur se eliminimi i parashtruesit është bërë në mënyrë të drejtë. Ndërsa sa i përket pretendimeve ankimore lidhur me tenderuesin e rekomanduar është gjetur se përderisa vet parashtruesi ka dorëzuar ofertë të papërgjegjshme, i njëjti nuk mund të trajtohet fare si palë e interesuar në kuptim të nenit 4 par. 1 nënpar. 26 të LPP. Pavarësisht kësaj është gjetur se oferta e dorëzuar nga tenderuesi i rekomanduar është në përputhje të plotë me të gjitha kërkesat e DT si dhe specifikat teknike të DT. Në këtë mënyrë është gjetur se parashtruesi ka dorëzuar ofertë të papërgjegjshme për të cilën me të drejtë është eliminuar nga aktiviteti i prokurimit ndërsa të gjitha pretendimet e tij ankimore janë të pabazuara në tërësi.

Nga sa u tha më sipër është gjetur se parashtruesi nuk ka paraqitur argumente të qëndrueshme për të mbështetur pretendimet e tij. Prandaj kërkesa për rishqyrtim e parashtruesit është refuzuar si e pabazuar në tërësi.

Për pikën I dhe II të këtij vendimi është vendosur duke u bazuar në nenin 63 par. 63.1.1. nënparagrafin b) lidhur me nenin 62 par. 62.1. nënparagrafin d) të Rregullores nr. 001/2022 për Prokurimin Publik. Për pikën III dhe IV të këtij vendimi është vendosur duke u bazuar në nenin 63 par. 63.2. të Rregullores nr. 001/2022 për Prokurimin Publik.

Bazuar në të thënat më sipër është vendosur si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Prishtinë, 05.05.2026

Visar SHEHU

Udhëheqës i Sektorit të Prokurimit
Komuna e Prishtinës

Këshillë juridike:

Pala e pakënaqur me këtë vendim mund të paraqes ankesë pranë Organit Shqyrtues të Prokurimit brenda afatit prej dhjetë (10) ditëve pas pranimit të këtij vendimi.